



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 29 janar 2020, në mbledhjen e XXI-të (njëzetënjë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr.52, ndërtesa e re e Komunës dhe filloi në orën 10;15.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, dhe Fitim Haziri, me përjashtim të Floretë Zejnullahu e cila ka dhënë dorëheqje nga cilësia e këshilltares së Kuvendit të Komunës për shkak të zgjedhjes Deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Abaz Llugaliu, Drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ, Zaim Thaqi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, Gëzim Namani, Drejtor i Drejtorisë së Administratës – DA, Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSH, Agim Blakçori, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, Mirsad Kamerolli, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, Durim Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit – DI, Hamdi Jaha, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, dhe Shkendiza Kllokoqi përfaqësuese e OSBE-së.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoj rreth pikave të paraqitura në këtë rend të ditës, shtoi, besoj që thirrjen materialin përkatës për këtë mbledhje e keni marrë të gjithë me kohë, andaj mund të vazhdojmë me punë.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar.

1. Draft Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2022 në Komunën e Podujevës

➤ *Raporti i diskutimit / debatit publik*

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i DPZHE, theksoi, Draft Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal, e ka kaluar debatin publik dhe gjatë kësaj periudhe sa ka qenë në debat publik kemi mirëpritur sugjerime, vërejtje dhe propozime prej grupeve të ndryshme, në ditën e debatit publik pjesëmarrja ka qenë në numër jo të madh, megjithatë ka pas prezent edhe anëtar të Kuvendit ku kemi diskutuar, kemi bërë shpjegime të dokumentit në fjalë ne si përfaqësues të Drejtorisë dhe po ashtu nga Kompania hartuese, por që nuk kemi pasur ndonjë propozim konkret, mirëpo debatit i kemi pasur 5 propozime që i ka jap këshilltari nga LVV-së z.Vendenis Lahu ku pothuajse të gjitha janë të përfshira në një formë në Draft

Strategjinë në fjalë, konkretisht pika ku thuhet të krijohet fondi prej 500.000.00€ nuk ka mundësi të inkorporohet në Strategji për arsye se ky fond është jashtë mundësive buxhetore të Komunës dhe është jashtë Kornizës Afatmesme Buxhetore, pastaj ne konsiderojmë se fondi për garanci kreditore është në nivel të Kosovës, këto kompetenca janë të ndërtuara në nivel vendi, ne si Drejtori kemi kontakt me fondin për garanci kreditore, do të mundohemi t'i informojmë edhe bizneset që t'i drejtojmë tek ky font që në të ardhmen të mund ta shfrytëzojmë këtë fond në nivel nacional, përndryshe të gjitha propozimet e tjera të Vendenisit që nuk po i cekë secilën sepse i keni në material, pra janë inkorporim direkt në Draft Strategji që e kemi paraqit dhe që do të jenë në dokumentin final dhe që shpresoj që të miratohen në seancën e radhës.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LDK-së e rekomandon këtë Draft Strategji të Zhvillimit Ekonomik Lokal për Kuvendin e Komunës si dhe raportin e diskutimit që është i bashkëngjitur për.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2022 në Komunën e Podujevës, përfshirë edhe plotësim ndryshimet përkatëse të evidentuara në raportin përkatës.

2. Propozim vendimi për vënie në shqyrtim publik Projekt – Harta Zonale e Komunës së Podujevës për periudhën 2020-2028.

➤ *Akti i vlerësimit të përputhshmërisë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.*

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, ne kemi afër dy viteve që punojmë Draft propozimin për hartën Zonale të Komunës së Podujevës për vitet 2020-2028, kemi bërë një punë jashtëzakonisht të madhe në bashkëpunim edhe me GIZ-in, kemi pasur disa takime edhe me qytetarë në fazën e parë, kemi pasur diskutim publik në Kerpimeh, Lluzhan, Sfeçël, Orllan dhe Podujevë dhe kur flasim për këtë në diskutimet publike, qytetarët nuk marrin pjesë në numër të madhe dhe pas shumë kohesh kur ata i sjellin propozimet e tyre ata thonë se nuk e kanë ditur që është mbajt diskutimi publik, tani e kemi shansin që në këtë seancë të kalon për diskutim publik, atëherë kanë mundësin që qytetarët të japin mendimin e tyre me vërejtje, sugjerime dhe ndihmë për Hartën Zonale sepse kjo ka një jetëgjatësi prej tetë viteve ngase më nuk ndryshohet, eventualisht pas katër viteve nëse ka kërkesë shumë të madhe mund të bëhen disa përmirësime. Ne kemi marrë edhe mendimin e fundit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe ju e keni edhe materialin ku ata kanë jap disa vërejtje dhe sugjerime që janë në kontekst të Hartës Zonale por në përfundim ata na kanë japë dritën e gjelbër që ne të kemi mundësi ta qesim në diskutim publik. Unë e kam paraparë edhe në diskutimin publik që mbas seancës me qenë data e diskutimit prej 04 shkurtë 2020 deri me 04 mars 2020 dhe një debat me qytetarët kamë paraparë që të jetë me datë 21.02.2020 në ora 13:15 ose nëse ju keni ndonjë sugjerim për orën e mbajtjes së diskutimit jemi të gatshëm , por diskutimi është në objektin e vjetër të komunës për shkak se salla atje është më e madhe. Për shkak të materialit që është i shumë i madhe ne ju kemi shpërnda në CD.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, Harta Zonale është një prej dokumenteve kyçe të Komunës për një periudhë të gjatë dhe duhet të angazhohemi të gjithë që ky akt të përmbillet edhe me të gjitha sugjerimet dhe vërejtjet që kanë ardhë dhe që janë në përgjegjësi të autoritetit përgjegjës të Komunës për planifikim dhe menaxhim hapësinor që gjatë hapjes së shqyrtimit publik t'i bëjmë mundësisht ashtu siç parashihet.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LDK-së e përkrah këtë pikë dhe besojmë shumë që me 21 shkurtë siç e tha edhe drejtori të kemi një prezantim që për ata që nuk janë të fushës ta kemi edhe më të qartë Hartën Zonale.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ky dokument është i një rëndësie të veçantë dhe kemi qenë të gjithë për që kjo pikë të vij sa më shpejt dhe t'i japim mbështetje këtij dokumenti. Sa i përket datës edhe orës atë e cakton drejtori, nuk kom diçka tjetër të shtoj, por e përkrahim.

z.Hamdi Jaha, drejtor i DPUMM, theksoi, njoftimin do ta kemi në web-faqe të Komunës, po ashtu do ti njoftojmë edhe dy mediat lokale që gjatë një muaji të kemi senzibilizim sa më të gjerë të qytetarëve dhe grupeve tjera të interesit.

*Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të propozim vendimit për vënie në diskutim publik Projekt Hartën Zonale të Komunës së Podujevës 2020-2028, duke mbështetur edhe propozimin që diskutimi publik të zgjatë 30 ditë, përkatësisht nga data **04 shkurt 2020 deri më 04 mars 2020**, ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më **21 shkurt 2020 duke filluar në ora 13;15** në ish sallën e mbledhjeve të Kuvendit në objektin e vjetër të Komunës.*

3. Propozim Rregullorja për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

➤ Raporti i diskutimit / debatit publik

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i DPZHE, theksoi, ne e kemi përfunduar diskutimin publik, kjo rregullore është bërë në bazë të një diskutimi të gjatë publik, ka pasur pjesëmarrje të mirë edhe në datën e diskutimit publik por edhe gjatë takimeve që i kemi pasur me sektorët e ndryshëm. Këtu dua ta falënderoj edhe Drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit i cili ka jap një kontribut jashtëzakonisht të madh në këtë fushë po ashtu edhe Drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Kemi pasur gjashtë takime, që i kemi cekur në material, me sektorë të ndryshëm por gjatë gjithë kësaj periudhe që kemi filluar këtë rregullore kemi pasur takime me individ të caktuar të fushave të ndryshme ku i kemi marr sugjerimet e tyre, jemi munduar që ta bëjmë një dokument i cili është në shërbim të qytetarëve dhe në shërbim të bizneseve. Një ndër kërkesat që ka qenë dhe është përsëritë në të gjithë sektorët ka qenë që dita e diel të jetë ditë pushimi me përjashtim të dy veprimtarive të caktuara, kjo ka qenë kërkesë edhe e bizneseve që nuk kanë të punësuar të tjerë përveç vetes por edhe i bizneseve që kanë të punësuar, do të thotë ka qenë kërkesë gati e unifikuar për të gjithë. Jemi munduar që kërkesat e të gjithëve pa i dëmtuar ata, t'i përfshijmë në këtë rregullore, e falënderoj edhe këshilltaren znj.Adelinë Stublla e cila kohë pas kohe ka bërë presion pozitiv dhe na ka shty ta bëjmë këtë rregullore dhe besoj që ka me qenë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe të gjitha bizneseve.

z.Durim Salihu, Drejtor i DI-së theksoi, dua të shtoj se roli dhe rëndësia e këtij dokumenti rreth orarit të bizneseve që operojnë në Komunën e Podujevës është më se i domosdoshëm. Është fat i madh që të gjitha llojet e bizneseve kanë kontribuar duke dhënë sugjerime dhe këshilla duke i drejtuar në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik që t'i inkorporojnë ato kërkesa të tyre dhe mund të themi se janë mbi 95% që janë realizuar ato kërkesa. Tek materiali që juve ju është ofruar unë e kam vërejtur krejt në momentin e fundit që është përvjedhë teknikisht, fjala është tek neni 15 pika 2.5 dhe 2.6, arsyeshmëria e pranimi të propozimit, mendoj se është e tepërt dhe nuk ka nevojë të jetë andaj edhe do të ishte mirë të hiqen.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nuk e kamë shikuar në detaje por nëse mirët vendimi që në Podujevë dita e diel me qenë ditë pushimi, nuk e di sa ka vakum ligjor në rregulloret e brendshme që i keni që eventualisht bizneset që duan të paguajnë është një koeficient i taksës që duhet të paguaj për atë ditë nëse duan të punojnë dhe ta mbajnë hapur biznesin.

z.Gëzim Namani, Drejtor i DA-së, theksoi, dëshiroj të paraqesë një vërejtje për të cilën po besoj që është gabim teknik, fjala është tek zbatimi i rregullores ku thuhet, zbatimin e bënë Policia dhe Gjykata, prandaj besoj se është mirë të ndryshohet, përkatësisht zbatimi t'i mbetet përgjegjësi Komunës, në bashkëpunim dhe koordinim me Policinë dhe Gjykatën.

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i DPZHE, theksoi, besoj që kur të miratohet është përqindje e madhe bizneseve që duan ta zbatojnë. Unë dhe Drejtori i DI, i kemi motivuar që ata të bashkëpunojnë dhe të jenë një lloj kujdestari për ta mbajtur rend dhe të gjithë janë pajtuar që do ta luajnë rolin e tyre si qytetarë, prandaj është mirë të miratohet kjo Rregullore sepse kemi qenë shumë keq pa të.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LDK-së e përkrah këtë propozim Rregullore, dokument ky i cili ka qenë jashtëzakonisht i mirëpritur nga bizneset, qoftë në diskutime publike qoftë si opinion i qytetarëve. Nuk është vetëm dita e diel e cila përflitet, por qytetarët respektivisht bizneset janë koncentruar shume edhe tek orari i punës sepse tregohet që punojnë deri në orën 7 ose 8 por që klientët pastaj mendojnë se ata punojnë deri në orën 10 ose 11. Mund të jetë sfidë, por jo që nuk do të mund të kryhet kjo punë nga Drejtoria e Inspeksionit, mirëpo për shkak të numrit të vogël të inspektorëve, duhet të mendojmë për staf shtesë që monitoron dhe përcjell gjendjen dhe vërtetë të kthehet një gjendje normale tek bizneset por edhe e konsumatorëve.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, dua të ndërlidhem tek e diela që tha z.Llapashtica, unë personalisht përveç pagesave që janë për të punuar të dielave, unë do të ndaloja të dielën krejt ngase punëtorët kanë të drejtë të pushojnë.

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i DPZHE, theksoi, ka qenë kërkesë edhe e bizneseve që e diela të jetë gjithqysh ditë pushimi, dhe duhet të respektohet orari.

znj.Adelina Stublla, theksoi, kam pyetje rreth orarit të barnatoreve, konkretisht për çështjen e kujdestarisë së natës, për shkak se ndihet nevoja e shumë pacientëve dhe neve që punojmë në ndërrimin e natës për shkak se për një ampull apo diçka të ngjashme mbeten pa marr terapinë.

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i DPZHE, theksoi, kam pasur gjashtë takime me përfaqësuesit e barnatoreve, kujdestaria e natës është edhe obligim ligjor ashtu siç më ka njoftuar edhe drejtori i DSHMS, barnatoret e kanë orarin e mbikëqyrjes së kujdestarisë së natës e të cilën e bënë drejtoria e cekur, e kanë orarin të cilin na e kanë dërguar një ditë më parë, nuk e kemi inkorporuar në dokument mirëpo, pra ata e kanë për obligim mbikëqyrjen e kujdestarisë së natës të ndarë me zona të caktuara. Barnatoret nuk e kanë doemos çështjen e fitimit për mbajtjen e kujdestarisë, por ne e kemi bërë obligim.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, tek pika 4.5 dhe 6, tek e diela që u përmend, thotë përjashtim në disa festa zyrtare, s'di a e kam kuptuar gabim por ka mbetë në diskrecionin e bizneseve që të punojnë nëse duan apo jo varësisht nga interesi i tyre. Thuhet se bizneset e lartcekura mund të punojnë me orar më të shkurtuar nëse biznesi e sheh të arsyeshëm, tash ky orari i shkurtuar a nënkupton se e kanë me patjetër të punojnë apo varësisht si është e rregulluar.

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i DPZHE, theksoi, kërkesat e operatorit ekonomik jemi munduar që me çdo kusht të mos ndihet i diskriminuar, asnjëra palë pa marrë parasysh fushëveprimtarinë e tyre që e punojnë. Dyqanet e vogla janë ankuar që në qendra tregtare i gjen të gjitha shërbimet pse na me mbyll në ora 8 ata në ora 10 atëherë i kemi lënë njëjtë për të gjithë, në qoftë se nuk ka llogari me mbajt deri vonë gjatë sezonit të dimrit mundet me mbyll më herët.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, unë po pyes vetëm tek kjo pjesa, të dielën dhe festave zyrtare nuk punohet pastaj neni 5 është përjashtim pika 4 e këtij neni bënë Nata e Bajramit apo nata e vitit të ri nëse bie ditën e diel apo në festë zyrtare, pastaj thotë se bizneset e lartcekura mund të punojnë me orar të shkurtuar nëse biznesi e vlerëson në interesin e tij, do të thotë të dielave punohet kur janë këto festa nëse ata duan sepse këtu po thotë nëse duan me orar të shkurtuar, pra ndoshta është dashtë të formulohet më mirë.

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i DPZHE, theksoi, kjo qe e ceku parafolësja ka mund të mbetet gabim tek formulimi, por jemi strikt te ajo se punë të detyrueshme nuk ka, jemi mundu me harmonizua për të gjithë në mënyrë të barabartë.

z.Durim Salihu, Drejtor i DI-së, theksoi, fjala është kështu, ditëve të punës prej të hënës deri të shtunën ka festë dhe nuk punohet, nëse të dielën qëllon të jetë festë atëherë varësisht nga fushverpimatria e biznesit, ai mund ta hap atë.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, siç është e shkruar, të dielave nuk punohet me përjashtim kur është festë punohet por bizneset munden të punojnë me orar të shkurtuar.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ditëve të festave nuk punohet përveç gjërave emergjente, tjerat nuk punojnë, këtu formulimi është të dielave nuk punohet, festave shtetërore punohet nëse dëshiron biznesi me orar të shkurtuar, do të thotë si pasus të rregullohet vetëm teknikisht.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, pika 4.5 dhe 6 është mirë të harmonizohen apo riformulohen.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të propozim Rregullores për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, duke përfshirë plotësim ndryshimet përkatëse të evidentuara në raportin përkatës dhe plotësim ndryshimet e propozuara nga mbledhja e KPF-së, dhe atë:

- Në nenin 6 të raportit, paragrafi 6 riformulohet si vijon “Bizneset e lartcekura, gjatë ditëve të punës mund të punojnë me orar më të shkurtuar nëse biznesi e vlerëson të arsyeshëm dhe në interes të tij”
- Në Nenin 15 i raportit fshihen në tërësi paragrafët 2.5 dhe 2.6, si dhe te **arsyeshmëria e pranimit të propozimit**, fshihet (si i panevojshëm) përshkrimi “Gjithashtu i mirëpresim propozimet e ordinancave private mjekësore sidomos në trajtimin e rasteve emergjente në çdo kohë, me kushtin që objekti ku ofrohet shërbimi jashtë orarit të përcaktuar duhet të jetë i mbyllur. Kurse sa i përket ordinancave stomatologjike dhe trajtimit të pacientëve jashtë orarit të përcaktuar, arsyeja ka qenë se QKMF nuk i trajton këto raste pas orarit të punës së institucionit”.
- Neni 21 i draft Rregullores, riformulohet si vijon: Zbatimin e kësaj Rregulloreje e bënë Drejtoria e Inspektionit, dhe Drejtoritë tjera përkatëse të Komunës, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Gjykatën kompetente.

4. Propozim vendimi për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, këtu duhet të formohet një komision i cili në seancën e radhës dy anëtar dalin nga kuvendi dhe një anëtar nga ekzekutivi. Për propozimin dhe caktimin e anëtarëve sigurisht do të vendosim në kuvend.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSh-së, theksoi, kompanitë regjionale në këtë rast ajo Pastrimi, që i ka shtatë njësi dhe çdo komunë i ka nga 3 anëtar në mënyrë të barabartë proporcionale dhe zakonisht bordi i thërret një herë në vit jo më shumë, nuk kanë qenë aktiv shumë më parë nuk kanë as ndonjë pagës por që tash bordi ka marrë vendim me i përtëri këta anëtarë, pra dy anëtar emërohen nga Kuvendi ndërsa një Kryetari i Komunës, ashtu siç janë rregulluar me Ligjin mbi shoqëritë tregtare dhe atë për ndërmarrjet publike. Do të thotë , i bëjnë politikat dhe i miratojnë politikat e Kompanisë, janë 21 anëtar nëse janë aktiv ndikojnë në bord dhe vendime.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të vendimi për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a, me rekomandim që në mbledhjen e Kuvendit të propozohen dhe emërohen 2 anëtarë/e të Komisionit në fjalë.

5. Kërkesa për ndihmë financiare e Qendrës së Rehabilitimit Bazuar në Bashkësi ‘HANDIKOS’ – Podujevë

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, materialin e keni marrë, nevojat arsyet e kësaj shoqate i dimë dhe i kemi të njohura. Sot na kanë sjell një plotësim i cili është planifikimi i buxhetit për vitin 2020 në mënyrë që të sqarohet sa më mirë plani buxhetit të tyre.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi nga radhët e LDK-së, e përkrah këtë kërkesë të Handikosit, ne e kemi potencuar edhe vitin e kaluar se sikur jemi mbet dhe jemi bllokuar në këtë shumën 14,000.00€, do të ishte mirë që të bisedojmë me ata persona dhe të tregojnë se shërbimet e tyre a janë rritur apo jo, por që shuma e buxhetit mbetet e njëjtë dhe nuk është shumë e arsyeshme që për 4 apo 5 vite radhazi me qenë buxheti në vazhdimësi i njëjtë, pra mendoj se duhet të gjejmë ndonjë alternativë që të ju rritet buxheti.

z.Fitim Haziri, theksoi, ne edhe vitin e kaluar kemi qenë për me mbështet këtë kategori por ajo çka po bien në sy është se ata vazhdimisht po bëjnë kërkesa por që nuk kemi ndonjë raport të prezantuar nga ata për ne se si janë menaxhuar ato mjete dhe që besoj që do të ishte më transparente dhe më e mirë dhe që ne kur ta marrim një vendim ta marrim shumë më lehtë dhe më mirë . kisha bërë një kërkesë për tërë atë shumë që kanë marrë sepse po ta shohim se bëhen gjithë ato aktivitete aty vetëm me këtë shumë, është mirë ta na sjellin një raport të aktiviteteve të tyre që i kanë pasur.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, t’ju them të drejtën me këtë menaxherin e Handikosit nuk kam kontaktuar, por as ne s’kemi kërkuar raport se ndoshta na kish sjell. Sa i përket shumës që ne do ta ndajmë si ndihmë, mendoj që kaq kanë kërkuar ata dhe e din sa kanë shpenzime. Pastaj nuk i dimë as mbetjet e borxheve sa i kanë por në një pasues këtu po thotë se ky buxhet nuk i plotëson kushtet e Handikos-it, mirëpo do të shohim edhe rrugët tjera përmes donatorëve. Kemi të bëjmë me një kategori të ndjeshme dhe duhet ti japim mbështetje por është mirë edhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të asistoi dhe t’i ndihmoi, duke përfshirë gjitha edhe forma dhe mundësi tjera.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, theksoi, Handikos-i është një OJQ, ne duhet ta kuptojmë që para Ligjit se OJQ-të çfarë statusi kanë. Ne duke ju falënderuar juve sa herë që kemi kërkuar mbështetjen na keni përkrahë për mbështetje aktivitetet e Handikos dhe jemi të gatshëm edhe ne që të kontribuojmë që ata me i perfeksionuar edhe me stafin dhe me punët e përditshme që ata i kanë. Çështja është që ne e kemi një buxhet i cili është i ndarë dhe i cili llogaritet që është për gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës dhe në fakt është për të gjitha OJQ-të që operojnë në Komunën e Podujevës, kur kemi të tilla si Handikosi ne duhet ta kemi parasysh se kemi të bëjmë me një OJQ pra e cila e ka statusin e barabartë me OJQ të tjera e që asnjë prej tyre nuk e kemi trajtuar ashtu sikurse Handikos-in. Prej këtu unë po i thërras të gjithë ata që kanë mundësi të kontribuojnë që ti rritet fondi Handikos-it, ta mbështetin një gjë të tillë. Pastaj kemi edhe organizatën tjetër që vazhdimisht kërkon ndihmë, e cila merret me strehimin e grave që janë viktimat të dhunës, por që nuk është në territorin e Komunës tonë, mandej ne privohemi nga e drejta tjetër që thotë që OJQ-të të ndihmohen ekskluzivisht atë që janë në territorin e komunës tonë, shembull, Komuna e Podujevës nuk ka organizatë që bënë strehimin e grave që janë viktimat të dhunës, ajo është në Prishtinë por që e njëjta kërkon fonde nga ne, kurse ne nuk kemi mundësi ti mbështesim ato edhe pse rreth 30% e atyre të strehuarave janë nga Komuna jonë, ndërsa ne s’kemi mundur ti mbështesim asnjëherë. Prej kësaj pozite unë e di që është pak për Handikos-in por është më së shumti e mundshme që mund të bëjmë prej këtij buxheti që kemi, e ku është një përqindje më e madhe e buxhetit tonë që e ndajmë për një OJQ.

z.Fitim Haziri, pyetje, a është e obliguar Komuna e Podujevës me pas strehimore të tillë.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, përgjigje parafolësit, ne jemi në regjionin e Prishtinës dhe komunat të cilat janë në këtë regjion, ligji nuk i obligon sepse po të ishte e obliguar me ligj do ta kishim ndërtuar

këtë qendër. Kjo është përgjegjësi morale më shumë sepse atë buxhet për atë OJQ e ndan Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

z.Avni Fetahu, theksoi, nga përvoja që kam sa ishte z.Agron Hyseni drejtor i DSHMS-së e di që ata vazhdimisht kanë raportuar dhe kanë qenë prej organizatave më të përpikta në punë, për këtë arsye edhe më brengos fakti kur e shoh këtë shumë të caktuar. I njoh shumë prej tyre që janë edhe fermer edhe për kundër problemeve shëndetësore që kanë ata, prapsepap ja dalin edhe me të hyra tjera. Në shkollën ku unë punoj, ajo Ekonomike “Isa Boletini” janë 4 persona me probleme të tilla e që kanë vullnet dhe gatishmëri Handikosi me bo aktivitete me ta, por në mungesë të mjeteve s’mundet ti realizojn, ata kanë vullnet dhe gatishmëri të punojnë por s’kanë mjete financiare të mjaftueshme dhe unë kisha sugjeruar që në të ardhmen ky buxhet të rritet edhe më shumë. Çështja tjetër është që nëse duhet ti nënshtrohen OJQ-ve, përkatësisht rregullës së aplikimit atëherë ne duhet të bëjmë vërejtje, apo ndoshta mund të jetë gabim që e votojmë, e them këtë duke marrë parasysh atë që drejtori parafolës e tha që organizatat duhet të bëjnë kërkesë, duhet ti nënshtrohen një procesi të aplikimit për donacione të caktuara.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, përgjigje parafolësit, për hir të aktiviteteve të handikos për të cilat mendoj se janë shumë specifike, kemi kaluar dhe e kalojmë. Ndërsa raportin unë e kamë në mënyrë të detajuar që e përshkruajnë aktivitetin e tyre të cilin e kan sjellë në DSHMS.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të kërkesës së “Handikos” për mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve programore dhe mbulimin e shpenzimeve operative të veprimtarisë, sipas objektivave strategjike për vitin 2020, me plotësim të kërkesës me dokumentin e planit financiar të “Handikos” e cila i bashkëngjitet konstatimeve.

6. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollorë 2019/2020

z.Agim Blakqori, Drejtor i Arsimit, theksoi, bazuar në Udhëzimin Administrativë të Ministrisë së Arsimit nr 18/2019 për kalendarin e vitit shkollor 2019-2020, periudha e parë e vitit 2019-2020 ka përfunduar me 30.dhjetor.2019. Drejtoria e Arsimit në funksion të përgatitjeve për fillimin e vitit shkollor 2019-2020 ka ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushtet për mbarëvajtjet e procesit mësimor për periudhën e par të kësaj periudhe. Shikuar në përgjithësi periudha e parë e vitit shkollor 2019-2020 në Komunën Podujevës ka përfunduar me sukses. Gjatë kësaj periudhe kohore shtator-dhjetor 2019 janë realizuar të gjitha punët dhe detyrat e planifikuara sipas dinamikës së paraparë në nivelet e arsimit para universitar në Komunën e Podujevës, por edhe punë dhe detyra tjera që janë paraqitur gjatë kësaj periudhe kohore. Pa dashur me ju ngarkua më shumë pasi e keni informatën e paraqitur , unë jam këtu nëse keni ndonjë pyetje apo koment.

znj.Adelina Stublla, theksoi, lidhur me shkollat profesionale më duket asnjëherë s’keni sjellë raport.

z.Agim Blakqori, Drejtor i DKA, theksoi, nëse është kërkesë mund ta sjell një informatë edhe për atë edhe pse shkolla e mesme e mjekësisë është e përfshirë në kuadër të shkollës ekonomike sepse aty edhe funksionon.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

7. Informatë e Drejtorisë së Administratës lidhur me zhvendosjen e personelit punonjës në ndërtesën e re të Komunës

z.Gëzim Namani, Drejtor i DA, theksoi, sipas planit të punës së Kuvendit për vitin 2020 ku është paraparë informatë e përgjithshme lidhur me zhvendosjen nga objekti i vjetër në objektin ri, në mënyrë që mos t'ju marrë kohë për detajet, materialin e keni, nëse ka pyetje unë jam këtu për tu përgjigjur.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, siç dihet objekti nuk është financuar dhe menaxhuar nga Komuna sepse i kemi disa vërejte tek organizimi i brendshëm i hapësirave publike por e dimë që drejtori dhe komuna s'kanë pasur qasje dhe financim në të dhe na kemi qenë të hendikepuar për këtë. Tash edhe salla e Kuvendit është e vogël dhe cenon pjesëmarrjen e mediave dhe të qytetarëve por s'ka qenë financim i Komunës dhe nuk e di sa ka mundur Komuna të ndërhy në këtë.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

8. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, sa i përket kësaj pike e keni raportin e prezantuar, janë takimet të cilat janë mbajtur, pothuajse është i realizuar i tëri në aspektin e mbajtjes së mbledhjeve dhe është tejkaluar sepse janë mbajtur 13 mbledhje, dinamika e këtij plani po ashtu ka qenë e përfillur dhe e zbatuar, ndërsa për përmbushje të këtij plani të këtij kuvendi ekzekutivi ka ofruar mbështetjen e duhur, duke përshtatur organizimin e mbledhjeve për realizimin e objektivave dhe agjendës sipas këtij plani. I gjithë ky bashkëpunim është realizuar me bashkëpunim të mirëfilltë sidomos të shefave të grupeve dhe të gjithë këshilltarëve që jem prezent në kuvend. Ky plan na ka ndihmuar dhe lehtësuar shumë punimet e kuvendit për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2019 që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve të Komunës së Podujevës, më gjerësisht e keni para vetes raportin.

z.Fitim Haziri, theksoi, Kryesues unë dua të njoftoj që ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së kemi zgjedhur si shef të grupit Vendenis Lahun.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, faleminderit ty për bashkëpunim e edhe atij i urojmë suksese si shef i Grupit.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim dhe vlerësim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0006887/20
Podujevë,
29 janar 2020**

**Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Gashi**